



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.54, datë 03.08.2018

PËR

**“SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT TË GRUPIT TË INSPEKTIMIT, PËR PENALIZIMIN
ME MASË ADMINISTRATIVE ME GJOBË NDAJ SUBJEKTIT TË INSPEKTUAR “UNIFI
HOLDINGS INC, DEGA NË SHQIPËRI””**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 03.08.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT TË GRUPIT TË INSPEKTIMIT, PËR PENALIZIMIN
ME MASË ADMINISTRATIVE ME GJOBË NDAJ SUBJEKTIT TË INSPEKTUAR “UNIFI
HOLDINGS INC, DEGA NË SHQIPËRI””**

BAZA LIGJORE:

1. Neni 132 e vijues të ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji 9918/2008*);
2. Neni 46 e ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë (*ligji 10433/2011*);
3. Ligji Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 44/2015*);
4. Ligji Nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (*ligji 10279/2010*)
5. Rregullore Nr.46 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendim Nr.2695, datë 27.10.2016;
6. Rregullore e Brendshme e Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacionin shpjegues për shqyrtimin e masës së gjobës së propozuar nga grupi i inspektimit.
2. ProjektAktin e formatuar dhe arsyetuar;
3. Autorizimin e Inspektimit Nr. 1719 Prot., datë 06.06.2018;
4. Vendim për shtyrje të Autorizimit të Inspektimit Nr. 1719/2 Prot., datë 04.07.2018;
5. Procesverbalin e Inspektimit Nr. 201, Datë 19.07.2018;
6. Dosje e plotë e Inspektimit.

VËREN:

1. Me Autorizimin e Inspektimit Nr.1719 Prot., datë 06.06.2018, grupi i inspektimit të AKEP ka filluar veprimtarinë inspektuese pranë sipërmarrësit “UNIFI HOLDINGS INC, Dega në Shqipëri”. Grupi i inspektimit, ka kryer njoftimet paraprake nëpërmjet komunikimit elektronik për fillimin e veprimtarisë inspektuese pranë sipërmarrësit “UNIFI Holding INC, Dega Shqipëri”, në datën 18.06.2018. Nga komunkimi elektronik i administruar nga grupi i inspektimit, rezulton se administratori i sipërmarrësit në fjalë nuk ndodhej efektivisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe për këtë arsye ka parashtruar kërkesën për shtyrjen e datës së inspektimit, me qëllim caktimin e një përfaqësuesi ligjor përgjegjës për vënien në dispozicion të inspektorëve të dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar, aksesin pranë ambjenteve teknologjike ku janë instaluar pajisjet, apo infrastruktura e rrjetit dhe facilitetet shoqëruese, si dhe për garantimin e bashkëpunimit dhe mos pengimin e kryerjes së veprimeve të inspektimit apo për dhënien e shpjegimeve të nevojshme.

2. Në këto kushte me Vendimin nr.1719/2, datë 4.07.2018, kohëzgjatja e inspektimit rezulton të jetë shtyrë me 10 (dhjetë) ditë kalendarike prej datës 04.07.2018 deri më datë 13.07.2018. Në këto kushte, përfaqësues ligjor i sipërmarrësit “UNIFI Holdings INC, Dega në Shqipëri”, është caktuar z. Andi Pacani. Grupi inspektimit ka marrë kontakte të menjëhershme me z. Andi Pacani, si dhe ka organizuar me të një takim pranë zyrave të AKEP më datë 06.07.2018. Përfaqësuesi ligjor, Z. Pacani, është përgjigjur pozitivisht grupit të inspektimit mbi kërkesën për depozitimin pranë zyrave të AKEP (brenda afateve të Autorizimit të Inspektimit) të listës së dokumentacionit të kërkuar nga grupi i inspektimit sipas tematikës së përcaktuar në Autorizimin e Inspektimit.
3. Në prezencë të përfaqësuesit ligjor z. Andi Pacani, si dhe të përfaqësuesve të Vodafone Albania, më datë 13.07.2018, grupi i inspektimit të AKEP ka verifikuar në terren paisjet e sipërmarrësit “UNIFI HOLDINGS INC, Dega në Shqipëri”, në adresën “Vodafone Albania Sh.A.”, Autostrada Tiranë - Durrës, Rr: “Pavarësia”, Nr.61, Kashar, Tiranë. Nga verifikimi i paisjeve në terren është konstatuar nga grupi i inspektimit fakti se ato ishin të ndezura dhe për këtë u pyet përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit “UNIFI HOLDINGS INC dega në Shqipëri” sh.p.k, i cili pohoi se nuk mund të jepte shpegime pasi nuk kishte dijeni të këtij fakti. Gjithsesi grupi i inspektimit konstatoi faktin se “Vodafone Albania” ka nënshkruar me sipërmarrësin “UNIFI HOLDINGS INC, Dega në Shqipëri”, një Marrveshje Interkoneksioni Ndërkombëtar në vitin 2014. Sipas parashikimeve të kësaj marrveshje, sipërmarrësi “UNIFI HOLDINGS INC, Dega në Shqipëri”, ka terminuar trafik ndërkombëtar në rrjetin e sipërmarrësit “Vodafone Albania”, dhe se aktualisht sipërmarrësi “Vodafone Albania” deklaroi se shërbimi i terminimit të thirrjeve është pezulluar pasi sipërmarrësi “UNIFI HOLDINGS INC, Dega në Shqipëri” nuk ka pranuar tarifën e re të terminimit të njoftuar nga sipërmarrësi “Vodafone Albania” në muajin Dhjetor 2017. Gjithashtu, sipërmarrësi “Vodafone Albania” deklaroi se vazhdon të mos të ketë **një kontratë terminimi** apo anulim të **Marrveshjes së Interkoneksionit Ndërkombëtar me sipërmarrësin “UNIFI HOLDINGS INC, Dega në Shqipëri”** por ka vetëm **pezullim shërbimi** deri në momentin që palët do të bien dakort për ndryshime në çmim.
4. Lidhur me depozitimin e dokumentacionit të kërkuar sipas tematikës së përcaktuar në Autorizimin e Inspektimit, grupi i inspektimit ka njoftuar përfaqësuesin ligjor z. Andi Pacani, në rugë elektronike datë 17.07.2018 se dokumentacioni i kërkuar nga grupi i inspektimit nuk ishte depozituar pranë zyrave të AKEP. Në email-in e datës 17.07.2018, z. Brian Shatku në cilësinë e administratorit të sipërmarrësit “UNIFI HOLDINGS INC, Dega Shqipëri”, njoftoi se dokumentacioni i kërkuar do të vihet në dispozicion të grupit të inspektimit nga përfaqësuesi i tij ligjor por në kushtet e një kordinimi të vështirë për shkak të largësisë kërkoi përsëri disa ditë shtesë për depozitimin e këtij dokumentacionit. Në këto kushte, grupi i inspektimit, bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e shqipërisë”, në të cilin është përcaktuar se kohëzgjatja e autorizimit të inspektimit mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare, meqënëse sipërmarrësit “UNIFI HOLDINGS INC, Dega Shqipëri”, ju dha njëherë mundësia e shtyerjes së afatit të

autorizimit, me përfundimin e afatit të autorizimit, ka vijuar me procedurën e përfundimit të inspektimit.

5. Sa më sipër, grupi i inspektimit, në referim me gërmën a), të pikës 1, të nenit 135, pikës 19, të paragrafit të I-rë, të nenit 137, të Ligjit Nr.9918/2008, i ndryshuar, i është drejtuar Këshillit Drejtues të AKEP me propozimin për penalizimin me masë administrative kryesore me gjobë në masën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, të sipërmarrësit “UNIFI HOLDING INC, Dega Shqipëri” për shkeljen e konstatuar si më poshtë:

- i. Sipërmarrësi “UNIFI HOLDINGS INC, Dega në Shqipëri” sh.p.k, edhe pas shtyerjes së afatit të Autorizimit të Inspektimit, si dhe pas tentativave të njëpasnjëshme të grupit të inspektimit nuk ka bashkëpunuar përgjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese duke penguar inspektorët e AKEP-it të hyjnë në mjediset, ku gjenden pajisjet e komunikimit dhe pajisjet teknike, si dhe nuk ka marrë masat e duhura për dorëzimin e të dhënave dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nga grupi i inspektimit brenda afateve kohor të përcaktuar sipas Autorizimit të Inspektimit.

6. Këshilli Drejtues i AKEP, në referim me dispozitat e ligjit material Nr.9918/2008, i ndryshuar, si dhe në zbatim të akteve rregullatore në fuqi, ka thërritur sipërmarrësin subjekt i veprimtarisë inspektuese, si dhe grupin e inspektimit në seancë dëgjimore në datë 03.08.2018, ora 11:00, pranë ambienteve të AKEP, me qëllim ballafaqimin dhe dhënien e shpjegimeve sa i përket çështjes në fjalë. Sipërmarrësi “UNIFI Holding INC, Dega Shqipëri”, në seancën dëgjimore me Këshillin Drejtues të AKEP është përfaqësuar me Autorizimin e datës 01.08.2018, nga AV. Alketa Uruçi dhe Z. Andi Pacani, Zyra Avokatore “Boga & Associates”.
7. Përfaqësuesit e sipërmarrësit “UNIFI Holding, Dega Shqipëri”, parashtuan gjatë seancës dëgjimore se për shkak të rrethanave në të cilat gjëndet shoqëria për shkak të mos ofrimit të asnjë shërbimi në treg, si dhe të mosprezencës efektive të administratorit të sipërmarrësit në territorin e Shqipërisë përgjatë inspektimit, janë shkaktuar vonesa në përgatitjen dhe dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar nga grupi i inspektimit, dhe se sipërmarrësi nuk është në pozicionin e refuzimit apo pengimit të inspektimit nga AKEP. Më tej, përfaqësuesit e sipërmarrësit “UNIFI Holding INC, Dega Shqipëri”, parashtuan dhe faktin se dokumentacioni i kërkuar nga grupi i inspektimit është dorëzuar në AKEP edhe pse me vonesë dhe jashtë afatit të përcaktuar në Autorizimin e Inspektimit, nga sipërmarrësi në datën 20.07.2018 (me nr.1719/4 prot, datë 20.07.2018 të AKEP). Në vijim, përfaqësuesit e sipërmarrësit “UNIFI Holding INC, Dega Shqipëri”, theksuan se në kushtet kur sipërmarrësi në fjalë nuk kryen efektivisht aktivitet, megjithëse nuk ka ezuaruar mjetet ligjore të ç’regjistrimit nga regjistrat përkatës të sipërmarrësve që ofrojnë shërbime/rrjeteve të komunikimeve elektronike, masa e gjobës e propozuar nga grupi i inspektimit nuk paraqet vlerë korrektuese në kushtet kur ky sipërmarrës nuk ka treguar vullnet të qartë për refuzimin e inspektimit por se ka qënë në kushtet e pamundësisë së paraqitjes së dokumentave dhe informacionit në kohën dhe sipas kushteve të vendosura në autorizimin e inspektimit.

8. Këshilli Drejtues i AKEP, pasi vlerësoi propozimin e grupit të inspektimit të paraqitur sipas Procesverbalit nr.201, datë 19.07.2018, shpjegimeve të dhënave nga përfaqësuesit e sipërmarrësit “UNIFI Holding INC, Dega Shqipëri”, si dhe të fakteve dhe rrethanave të çështjes, gjykon se sipërmarrësi “UNIFI HOLDING INC, Dega Shqipëri”, përgjatë zhvillimit të veprimtarisë inspektuese nuk ka shfaqur refuzim apo pengim absolut të inspektimit nga AKEP. Në referim dhe zbërthim të dispozitave ligjore që rregullojnë fushën e inspektimit në Republikën e Shqipërisë, subjekti “UNIFI HOLDING INC, Dega Shqipëri”, Këshilli Drejtues i AKEP nuk mund të konsiderojë si refuzim apo pengim të veprimtarisë inspektuese në një kohë që grupi i inspektimit ka pasur komunikim të vazhdueshëm me subjektin “UNIFI HOLDING INC, Dega Shqipëri”, si dhe të dhënat dhe dokumentacioni i kërkuar nga grupi i inspektimit janë dorëzuar, dhe pse jashtë afatit të përcaktuar në Autorizimin e Inspektimit, për shkaqe të cilat nuk mund të konstatohen si pengim apo moslejim të veprimtarisë inspektuese. Natyrisht dispozita përkatëse, në mbështetje të së cilës grupi i inspektimit ka propozuar penalizimin e subjektit me masë administrative me gjobë, konkretisht pika 19, e paragrafit I, të nenit 137, të ligjit 9918/2008, kërkon që shkelja të jetë kryer me faj, dhe si e tillë të jetë e hapur dhe flagrante. Parashikimi në këtë dispozitë, të masës me gjobë në nivel mjaft të lartë, do të thotë që qoftë shkelja si e tillë, ashtu dhe shkalla e rëndë dhe serioziteti i saj i skajshëm të jenë lehtësisht të dallueshme dhe të pajustificueshme.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në referim të neneve 128 e vijues të ligjit nr. 44/2015, gjurmës a), të pikës 3, të nenit 135, të ligjit nr.9918/2008, si dhe të gjurmës d), të pikës 3.8, të Rregullores Nr.46, datë 27.10.2016 “*Metodika e Inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike*”, si dhe duke pasur në vëmendje kriteret për caktimin e llojit dhe të masës së dënimit në referim me Ligjin 10279/2010, “Për kundërvajtjet administrative”, Këshilli Drejtues i AKEP:

V E N D O S:

1. Ndryshimin e masës administrative kryesore me gjobë në masën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, të propozuar nga Grupi i Inspektimit.
2. Dhënien e masës administrative kryesore me “**Paralajmërim**” në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, ndaj sipërmarrësit “UNIFI HOLDING INC, Dega Shqipëri”.
3. Sipërmarrësi “UNIFI HOLDING INC, Dega Shqipëri”, të marrë të gjitha masat e nevojshme për t’i mundur inspektorëve të AKEP, realizimin e inspektimit të ri, brenda datës 30.09.2018.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al;

5. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Ilir ZELA

ANËTARË TË KËSHILLIT DREJTUES:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Edlira DVORANI**
- 3. Ketrin TOPÇIU**
- 4. Klarina ALLUSHI**